



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-13060/24 datë: 23.05.2024



Npi – 01/189 datë: 27.05.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 27.05.2024 (e hënë) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 26.04.2024,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik),
3. Informatë e përgjithshme mbi gjendjen në arsim për komunitetet ashkali, rom dhe braktisja te këto komunitete,
4. Informatë për mbështetjen e komuniteteve ashkali dhe rom në fushën e Rinis,Kulturës dhe Sportit,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, propozoj që pika 3 të bartet për muajin e ardhshëm.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, mendoj se duhet me u diskutu pika e 3 sot sepse kemi diskutuar me OJQ-në ku unë marrë pjesë, dhe e kemi kthyer dhe e kemi bindur një nxënës që nuk ka dashtë me shku në shkollë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne mund ta shtyjmë këtë pikë, dhe të vendosim që të shkojmë për vizita në shkollat e Komunës së Shtimes në pikën “të ndryshme”.

z.Besnik Seferi; Pajtohem me Rrezartën për me u shty kjo pikë. Por deshta me pyet Muhametin se për çfarë arsye po ndodhë kjo braktisja dhe a është ndërrmarrë diçka prej kur kemi diskutuar bashkë? Duke mos qenë drejtoresha ne jemi për me u shty kjo pikë. Pyetjeve duhet me ju përgjigjë drejtoresha.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Konstatohet Kuorumi prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*Komiteti për Komunitete me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratori rendin e ditës pa pikën 3 si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 26.04.2024,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik),
3. Informatë për mbështetjen e komuniteteve ashkali dhe rom në fushën e Rinis, Kulturës dhe Sportit,
4. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 26.04.2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 26.04.2024.

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Dihet që KAB-i 2025-27 do të shkojë në diskutim publik, por unë kisha kërkuar një gjithëpërfshirje. Për fat të mirë sivjet janë futur kërkesat tona si KPK.

znj.Rrezartë Ramadani; Pasi shkon në diskutim publik nuk ja vlenë me e zgjatë diskutimin më shumë, por që unë po kërkoj që ne të jemi pjesë aktive e diskutimit publik për KAB-in 2025-27.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi Është mirë që edhe sivjet diskutimet të bëhen veq e veq në fshatra sikurse vitin e kaluar, ky është rekomandimi im.

* Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për 2025-2027, me propozimin që diskutimi publik të organizohet edhe nëpër fshatra.

Pika 3

Informatë për mbështetjen e komuniteteve ashkali dhe rom në fushën e Rinis, Kulturës dhe Sportit,

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Te faqja 2 e informatës shkruan që: “Për 15 Shkurtin, DKRS-ja ka bashkëpunuar me OJQ-të, kjo nuk është e vërtetë, por ka bashkëpunuar me një individ, dhe informata në këtë pjesë nuk është e vërtetë.

z.Besnik Seferi; Unë nuk jam i kënaqur me informatën, sepse ne kemi kërkuar informatë për Komunitetin pakicë, e jo informatë të përgjithshme të drejtorisë, kjo është vërejtja ime për këtë informatë. Çka ka qenë kërkesa juaj Kryesues që drejtoresha nuk u është përgjigjur juve, por vetëm një personi siq po thuani. Nuk e di sa organizata ose OJQ-ë janë, edhe sa subvencione kanë marrë. Këto shqetësime unë personalisht kam me i adresuar në Kuvend.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Drejtoresha ka thënë se vetë nuk mundet me marrë përsipër me organizu dhe financu organizimin e manifestimit të 15 shkurtit. Duhet me pranë se kërkesën e kemi bërë pak me vonësë. Gabimi ka qenë i dy anëshëm. E papranueshme ka qenë injorimi i Këshillit Organizativ nga Drejtoresha. Kemi kërkuar që në të gjitha manifestimet që organizohen të merrë pjesë ndonjëri nga pjestarët e Komitetit Pakicë.

znj.Rrezartë Ramadani; Ndoshta arsyeja ka qenë, kërkesa e bërë me vonësë që e keni bërë, ju edhe vetë e pranuat këtë.

z.Mehmet Mehmeti; Mjete financiare e dimë që nuk ka, mirëpo vonesa e paraqitjes së kërkesës nuk është pengesë sepse mjetet mund ti marrin hua sikur që ka ndodhur edhe më herët. Këshilli ka mbajtur takim edhe me Nënkryetarin.

z.Besnik Seferi; Drejtë me thënë se mënyra qysh e paskeni bërë kërkesën për dreka e darka, fare nuk po më pëlqen, sepse ne si subjekt politik jemi bukur kritik. Unë më herët kam qenë i kënaqur personalisht me mënyrën e organizimit me muzikë dhe argëtim shumë të mirë.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Kemi qenë në takim me Ministrin e MAPL-së z.Albert Krasniqin, dhe kemi marrë zotim se ka me avansuar qështjen e zgjidhjes të vendit të punës te ZKKK-ja dhe na ka thënë se kjo kërkesë e juaj do të mbështetet. Në takim kanë qenë unë dhe Muhamet Mehmeti. Ju lus që në takimin e punës më datën 31.05.2024 e premtë me qenë prezent anëtarët e KPK-së, sepse unë nuk do të jem këtu. Kur po dakordohemi me shkuar për vizita në shkolla.

znj.Rrezartë Ramadani; Ndoshta nuk është mirë me shku në fund të vitit shkollor.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ndoshta është mirë me shku në shkollën e Muzeqinës dhe të Shtimes në javën e ardhëshme. Unë u dërgojë kërkesën për të Hënën më 03.06.2024.

z.Besnik Seferi; Ta bëjmë takimin por duhet me u parapregaditë dhe duhet ta dimë rekomandimin për DKA-në. Sa i përket Planit të Veprimit duhet të diskutojmë për zbatimin e tij e jo me mbetë vetëm i shkruar në letër.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 16:07h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

